

Për ne, shpërndarja e produkteve farmaceutike do të thotë dërgimi i produktit të sigurtë, cilësor në kohë dhe vendin e duhur. Shërbimet të cilat krijojnë vlerë të shtuar për palët e interesit të jashtme janë bërë faktor me rëndësi konkurruese në shpërndarjen e produkteve farmaceutike dhe atyre të kujdesit shëndetësor duke i dhënë kompanisë sonë për dallim nga konkurrenca në treg.

Kredibiliteti dhe besimi: Ne mbajmë premtimet! Klientët tanë mund të mbështeten në shërbimet tona sipas standardeve ndërkombetare të sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001, praktikave të mira të ruajtjes GSP , praktikave të mira të shpërndarjes GDP poashtu kërkesat ligjore në fuqi. Kjo është rezultat i promovimit të aftësive individuale dhe motivimit të punëtorëve tanë gjë që na mundëson të përmirësojmë në vazhdimësi shërbimet për klientet tonë.

Empatia dhe kënaqësia e klientit: Në bashkë ndiejmë me pacientin si dhe identifikojmë ne vazhdimësi nevojat dhe kërkesat e konsumatorit dhe palëve tjera të interesit duke në vazhdimësi punojmë që ti plotësojmë dhe ti tejkalojmë ato. Është traditë dhe është dëshmuar se në kompaninë tonë klienti konsiderohet si forca shtytëse në përpjekjet e kompanisë për të arritur cilësinë më të lartë të mundshme përmes menaxhimit të shkëlqyeshëm të resurseve të saj-personelit, pajisjeve, materialit dhe mjedisit.

Nëpërmjet zbatimit të sistemit të menaxhimit të cilësisë sipas 9001:2015, praktikave të mira të ruajtjes GSP dhe praktikave të mira të shpërndarjes GDP, do të arrijmë përmbushjen e kërkesave të klientit, produktit, shërbimit, pronarëve, punonjësve dhe shoqërisë.

Për të arritur qëllimin tonë menaxhmenti dhe punonjësit e Santefarm janë të obliguar që të:

- përmbushin kërkesat e klientit,
- veprojnë sipas përgjegjësisë të ndara dhe procedurave të përcaktuara,
- përmbushen në vazhdimësi kërkesat që dalin nga standardi dhe praktikat e mira të shpërndarjes ,
- përmirësojnë efektivitetin të proceseve punuese,
- ngrisin në vazhdimësi aftësitë e punonjësve,
- veprojnë në mënyrë preventive me qëllim të evitimit të jokonformiteteve,
- njohin, zbatojnë dhe rishikojnë politikën e menaxhimit të cilësisë

Obligimet e vendosura mund të arrihen vetëm me dije, profesionalizëm, përvojë dhe motivim të punonjësve tanë, ngritjen e aftësive të tyre gjithashtu edhe përcjelljes së zhvillimit teknologjik dhe kërkesave të tregut.

Drejtor,
Milaim Abdullahu



Data : 08.02.2021